



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 2070/23

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Isa Hasani - Kryetar, Batisha Ibrahim - Anëtare si dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Ministrisë së Shëndetësisë me numër 2070/23, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE D&T Group - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me autoambulanca për nevoja të MSH-se, me nr: te prokurimit: 206-23-11548-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, më: 24.09.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Ministrisë së Shëndetësisë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE D&T Group - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me autoambulanca për nevoja të MSH-se, me nr: te prokurimit: 206-23-11548-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë.

A R S Y E T I M

Kërkesa e AK- Ministria e Shëndetësisë:

Autoriteti kontraktues pretendon se OE D&T Group, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me autoambulanca për nevoja të MSH-se, me nr: te prokurimit: 206-23-11548-1-1-1, gjatë vlerësimit të ofertave, konkretisht ofertës së operatori ekonomik D&T Group, ka vërejtur ndërhyrje në katalogun e dorëzuar.

Autoriteti kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të verifikimit të katalogut, me datën: 15.11.2023, i është drejtuar me shkrim kompanisë Euroimpex (dilerit të autorizuar) – Maqedoni e Veriut.

Ne përgjigje te kërkesës se AK-MSH-se, te njëjtit kanë deklaruar se nuk qëndrojnë prapa atij katalogu dhe se nuk është ofruar nga ana jone, pra nuk është katalogu zyrtare i Peugeot.

Po ashtu ne te njëjtën date, AK-MSH-ja i është drejtuar edhe kompanisë Gima – Itali me qëllim te verifikimit te specifikave teknike, te njëjtit ne përgjigje kan deklaruar qe ti referohen faqes nr. 366 me kod 35205, e qe sipas AK-se ndryshon me katalogun e prezantuar ne ofertë.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 06.12.2023 te AK - Ministria e Shëndetësisë, e ka njoftuar OE D&T Group, me qëllim qe operatori ekonomik në fjale të jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

Ne përgjigje te kërkesës se OSHP-se, OE D&T Group, ka dhënë përgjigjen lidhur me kërkesën e AK-se, i cili e kundërshton ne tërësi dhe njëherit kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, qe kërkesa e AK-se për marrjen e masave te refuzohet, duke e arsyetuar se AK-ja, i ka ven ne lajthitje prodhuesit duke ju dërguar vetëm disa faqe te katalogut ne këtë rast katalogut te autoambulancës/mbindërtimit dhe jo te gjithë automjetit ashtu siç e kemi ngarkuar ne në E-Prokurim.

Me tutje ne deklarimin e tij OE D&T Group, sqaron se ne këtë procedure te prokurimit kemi te bëjmë me mbindërtim dhe superstruktura, pajisje te cilat kombinohen dhe modifikohen sipas specifikave teknike te detyrueshme, deklarate te cilën e kemi prezantuar ne ofertën tone. OE D&T Group, deklararon se AK-MSH, me sqarimet e kërkuara ju është referuar kompanisë ofertuese i është referuar distributoreve te shteteve tjera te cilët nuk kanë qene fare ne dijeni se për cilin projekt behet fjale.

Sa i përket kërkesës se AK-MSH-se, përmes email-it ka reaguuar edhe anëtari i konzorciumit, i cili ka deklaruar se pas kërkesës se OE D&T Group, për te formuar grupin e OE-ve, ne i kemi dërguar te gjitha dëshmitë origjinale dhe për te njëjtat ka dorëzuar edhe dëshmitë e dërgimit, te cilat i ka bere përmes emailit.

-Vlerësimi i pretendimeve te autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj D&T Group.

Pavarësisht faktit që ka një konfirmim se për katalogun e dorëzuar nga OE D&T Group, ku kompania Euroimpex ka deklaruar se nuk e kanë dorëzuar dhe se nuk qëndrojnë prapa katalogut, është e nevojshme qe ky pretendim fillimisht të hetohet nga organet përgjegjëse për faktin se pretendohet për falsifikim te dëshmimeve dhe nuk është në kompetencën e OSHP të hetohet një pretendim i tille. Njëherit lidhur me këtë çështje OSHP, përmes emailit i ka kërkuar autoritetit kontraktues qe lënda të dërgohet ne hetuesi dhe vetëm pas pranimit te rezultatit te hetimeve mund te merr mund te merr masa eventuale ndaj OE D&T Group. Prandaj fillimisht dëshminë në fjale duhet ta hetojnë organet kompetente dhe pastaj të konstatohet sakte pretendimi i AK-se për falsifikim dhe mbi bazën e provave të cilat do te prezantohet komisioni do te jep vlerësimet.

OSHP, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave konstaton se autoriteti kontraktues –Ministria Shëndetësisë, nuk ka dorëzuar prova të mjaftueshme që dëshmojnë se D&T Group, në këtë aktivitet të prokurimit, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj operatorit ekonomik.

Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se D&T Group ka mashtruar apo falsifikuar dëshmi e prezantuar në oferte për faktin se prodhuesi nuk e ka konfirmuar se është ndërhyrë në katalog. Prandaj në mungesë të provave kërkesa e Autoritetit kontraktues duhet të refuzohet fillimisht, pasi dëshmitë e ofruara nuk përbën baze ligjore për marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se.

Pra, Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi konkrete apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e D&T Group për aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Autoambulanca për nevoja të MSH-së, me nr: të prokurimit: 206-23-11548-1-1-1.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ministria e Shëndetësisë

1x1 OE D&T Group.

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.